

Në bazë të nenit 9-b, paragrafit 2, të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 05/07, 103/08, 124/10, 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 dhe 64/18) dhe dispozitat e Rregullores për përmbajtjen dhe formën e aktit të video mbikëqyrjes ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër. 158/10) dhe nenit 27, paragrafit 1, pikës 6, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit Evropës Juglindore në mbledhjen e mbajtur më 9.09.2019, e miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MËNYRËN E REALIZIMIT TË VIDEO MBIKËQYRJES NË UNIVERSITETIN E EVROPËS JUGLINDORE

I. Objekti i rregullimit

Neni 1

Në këtë rregullore përshkruhet mënyra e video mbikëqyrjes në Universitetin e Evropës Juglindore (në tekstin e mëtejme: UEJL), i cili paraqitet në cilësi të kontrolluesit, si dhe masat teknike dhe organizative që do të aplikohen për të siguruar besueshmërinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale përmes realizimit të video mbikëqyrjes, periudhën e ruajtjes së video regjistrimeve, mënyrën e fshirjes, mënyrën e realizimit të kopjes së sigurisë (backup) dhe të drejtat dhe detyrimet e personave të autorizuar, që kanë qasje në sistemin për video mbikëqyrje.

II. Përshkrimi i sistemit për video mbikëqyrje

Neni 2

- (1) Video mbikëqyrja realizohet nëpërmjet kamerave të vendosura në hapësirat e UEJL-së, ku të njëjtat janë të drejtuara vetëm në zonat kritike në UEJL.
- (2) Incizimet nga kamerat ruhen në pajisje DVR në hapësirën qendrore të serverit në UEJL. Qasje në këto video materiale ka personi i autorizuar nga Shërbimi i sigurimit.
- (3) Incizimet nga video mbikëqyrja ruhen në hard diskun e pajisjes DVR, në hapësirën qendrore të serverit në UEJL.

III. Qëllimi për video mbikëqyrje

Neni 3

Video mbikëqyrja realizohet për të siguruar:

- mbrojtjen e pronës; dhe
- sigurimin e kontrollit mbi hyrjet dhe daljet nga ambientet zyrtare të UEJL-së.

IV. Rishikimi periodik

Neni 4

- (1) UEJL (Shërbimi i sigurimit/Mirëmbajtjes), çdo dy vjet kryen vlerësim periodik të rezultateve të sistemit për video mbikëqyrje, veçanërisht për:
- nevojat e mëtejshme për përdorimin e sistemit për video mbikëqyrje;
 - qëllimin, ose qëllimet për video mbikëqyrje;
 - zgjidhjet e mundshme teknike për të zëvendësuar sistemin për video mbikëqyrje;
 - treguesit statistikorë për qasje në imazhet e marra nga video mbikëqyrja; dhe
 - mënyrën e përdorimit të incizimeve.
- (2) Për vlerësimin periodik të kryer sipas paragrafit 1, të këtij neni, Shërbimi i sigurimit përgatit raport, që është pjesë e dokumentacionit për ngritjen e një sistemi të video mbikëqyrjes.

V. Përpunimi i të dhënave personale

Neni 5

Nëpërmjet sistemit për video mbikëqyrje përpunohen kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale:

- Pamja fizike dhe fiziologjike e palëve që hyjnë dhe dalin nga ambientet e UEJL-së; dhe
- Pamja fizike dhe fiziologjike e të punësuarve në UEJL.

VI. Masat teknike

Neni 6

UEJL i ofron masat teknike të mëposhtme për fshehtësi dhe mbrojtje të përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit për video mbikëqyrje, edhe atë:

1. Emër përdoruesi unik për çdo person të autorizuar;
2. Fjalëkalim i krijuar nga çdo person i autorizuar, i përbërë nga një kombinim i të paktën tetë karaktereve alfanumerike (nga të cilat të paktën një shkronjë të madhe) dhe karaktere speciale;
3. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi i sigurojnë qasje personit të autorizuar në sistemin për video mbikëqyrje në tërësi, ose në aplikacionet individuale;
4. Çregjistrimi i automatizuar nga sistemi për video mbikëqyrje, pas mbarimit të një periudhe prej pasivitetit (jo më shumë se 15 minuta), pas së cilës, për ta riaktivizuar sistemin, kërkohet rihyrje në emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimi;
5. Refuzim automatik nga sistemi për video mbikëqyrje pas tre përpjekjeve të pasuksesshme për regjistrim (futje të emrit të përdoruesit apo fjalëkalimit të gabuar);
6. Pengesë mbrojtëse softuerike në rrjet (*firewall*), ose ruter në mes sistemit për video mbikëqyrje dhe internet, apo çfarëdolloj forme tjetër e rrjetit të jashtëm, si masë mbrojtëse kundër tentimeve të palejueshme, ose keqdashëse për hyrje, ose thyerje të sistemit;
7. Lidhje të sistemit të video mbikëqyrjes në rrjet për furnizim të pandërprerë, me energji elektrike.

VII. Masa organizative

Neni 7

- (1) UEJL i ofron masat organizative të mëposhtme për fshehtësi dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit për video mbikëqyrje edhe atë:
 1. Qasje të kufizuar apo identifikim për të hyrë në sistemin e video mbikëqyrjes, kështu që vetëm personat e autorizuar të UEJL-së mund të kenë qasje në sistemin për video mbikëqyrje;
 2. Çdo person i autorizuar ka qasje të kufizuar në sistemin për video mbikëqyrje në lidhje me shkarkimin dhe regjistrimin e video materialeve;
 3. Asgjësim të video materialeve pas skadimit të afatit për ruajtje të të njëjtave dhe
 4. Respektim i udhëzimeve teknike gjatë instalimit dhe përdorimit të pajisjeve për video mbikëqyrje.
- (2) Me kërkesë të Departmentit të ngrehinave dhe kapaciteteve teknike, Zyra e burimeve njerëzore e njofton Departamentin e TI-së, për angazhimin e cilitdo/secilit person të autorizuar me të drejtë qasjeje në sistemin për video mbikëqyrje, që t'i jepet emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi, si dhe pas përfundimit të punësimit apo angazhimit t'i fshihet emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi, ose t'i bllokohen për qasje të mëtejshme.
- (3) Njoftimi sipas paragrafit 2, të këtij neni do të bëhet edhe gjatë cilitdo ndryshim tjetër në statusin e punësimit, apo në statusin e angazhimit të personit të autorizuar, i cili ka ndikim në nivelin e qasjes së lejuar në sistemin e informacionit.

VIII. Regjistrimi i qasjes dhe inspektimit

Neni 8

Për qasjen dhe inspektimin e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit për video mbikëqyrje në UEJL, mbahet evidencë, me të dhënat në vazhdim:

- Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar;
- Data dhe koha e qasjes;
- Qëllimi i qasjes;
- Data dhe koha incizimit për të cilën është dhënë qasja;
- Data dhe koha, emri dhe selia e shfrytëzuesit, të cilit i është dhënë incizimi nga video mbikëqyrja;
- Lloji i mediumit në të cilin është ruajtur incizimi i video mbikëqyrjes.

IX. Persona të autorizuar për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video mbikëqyrjes

Neni 9

- (1) Qasje dhe vështrim në të dhënat personale, të përpunuara nga sistemi për video mbikëqyrje, kanë personat e autorizuar për kryerje të kontrollit të zonave kritike.
- (2) Personat e autorizuar, nga paragrafi 1 i këtij neni, para fillimit të punës, ose para qasjes në sistemin për video mbikëqyrje, nënshkruajnë deklaratë për besueshmëri dhe mbrojtje të të dhënave personale.

- (3) Formulari, për deklaratën nga paragrafi 2 i këtij neni, është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje (Formulari 1).

X. Afati i ruajtjes së incizimeve nga video mbikëqyrja

Neni 10

- (1) Në incizimet nga video mbikëqyrja, të cilat ruhen në hard disk në DVR, kanë qasje vetëm administratori i sistemit të informacionit dhe personat e autorizuar për kontrollin e zonave kritike në UEJL.
- (2) Incizimet nga video mbikëqyrja ruhen 15 ditë, të cilët pas skadimit të afatit, automatikisht fshihen nga hard disku në të cilin ruhen.
- (3) Incizimet e nxjerra nga video mbikëqyrja mund të ruhen për një periudhë më të gjatë kohore se sa periudha e specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, nëse është e nevojshme sipas ligjit, por jo më gjatë se nga përmbushja e objektivave.

XI. Njoftimi për video mbikëqyrje

Neni 11

- (1) Në zonat kritike në Universitetin e Evropës Juglindore, në vende të dukshme qartë janë vënë njoftimet për video mbikëqyrje:
- Kryhet video mbikëqyrje;
 - Emri i kontrolluesit, i cili e realizon video mbikëqyrjen, dhe
 - Mënyra se si mund të merren informata për atë se ku dhe sa kohë ruhen incizimet nga sistemi për video mbikëqyrje.
- (2) Informimi, nga paragrafi 1 i këtij neni, është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje (Formulari nr. 2).

XII. Specifikacione teknike të pajisjeve

Neni 12

- (1) Për realizimin e video mbikëqyrjes përdoret sistemi, i cili përbëhet nga kamera statike, të cilat mbikëqyrin hapësira të jashtme dhe të brendshme, digjitale dhe analoge që ofrojnë rezolucion maksimal për incizim prej 2M pixela, ku të njëjtat kryejnë incizim 24 orë, pa mundësinë për fokusim (*zoom*) dhe përmban mbështetje për incizim në hapësira të errëta.
- (2) Në sistemin për video mbikëqyrje mund të ketë qasje nga dy stacione pune edhe atë përmes kompjuterit në Shërbimin e Sigurimit.

XIII. Plani për vendosjen e sistemit për video mbikëqyrje

Neni 13

Paraqitja grafike e vendosjes së sistemit për video mbikëqyrje, hapësira ku kryhet video mbikëqyrja, këndi i mbulimit të hapësirës ku kryhet video mbikëqyrja, si dhe harta me vendet

ku janë të vendosura kamerat, janë përfshirë në Planin, i cili është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje (Shtojca nr.1).

XIV. Dispozitat plotësuese

Neni 14

Gjatë përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit për video mbikëqyrje, në mënyrë të përshtatshme aplikohen edhe dispozita të tjera të Rregullores për masa teknike dhe organizative për të siguruar besueshmërinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 38/09 dhe 158/10).

XV. Dispozitat përfundimtare

Neni 15

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 01.10.2019.

Formulari 1

Në bazë të dispozitave nga Ligji për mbrojtje të të dhënave personale (Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë nr. 7/05, 103/08, 124/10 dhe 135/11, 43/14, 153/15, 99/16 dhe 64/2018), më, 20 jap

DEKLARATË

për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale përmes sistemit për video mbikëqyrje

Unë i/e poshtë nënshkruari/a,

.....,

(emri dhe mbiemri)

në në pajtim me

(vendi i punës)

(sektori/departamenti)

Rregulloren për video mbikëqyrje në UEJL për mbrojtjen e të dhënave personale, marr përsipër se:

- do t'i zbatoj parimet për mbrojtjen e dhënave personale në kryerjen e video mbikëqyrjes;
- do t'i zbatoj masat teknike dhe organizative për të siguruar besueshmërinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale dhe do t'i ruaj si të dhënat e besueshme personale, si dhe masat për mbrojtjen e tyre;
- do t'i zbatoj masat teknike dhe organizative për qasje dhe inspektim në të dhënat personale të përpunuara nëpërmjet sistemit për kryerje të video mbikëqyrjes nëpërmjet të cilit sistem nuk lejohet qasje dhe inspektim i paautorizuar dhe i paregjistruar në incizimet e sistemit për video mbikëqyrje;
- do të bëj përpunimin e të dhënave personale në përputhje me udhëzimet e marra nga kontrolluesi;
- personave të tretë, me përjashtim të kontrolluesit dhe personave tjerë nga kontrolli, nuk do t'u jap asnjë të dhënë personale nga incizimet e video mbikëqyrjes, ose çfarëdo lloj të dhëne tjetër personale në të cilat kam qasje dhe të cilat i kam kuptuar, ose do t'i kuptoj gjatë kryerjes së video mbikëqyrjes në kontroll, përveç nëse në ligj nuk është parashikuar ndryshe.

Nënshkrimi,

.....

Formulari 2

NJOFTIMI PËR KRYERJE TË VIDEO MBIKËQYRJES



Objekti është nën video mbikqyrje
Објектот е под видео надзор
The object is under video surveillance

Kontrollori | Контролор | Controller

Formulari nr. 1

Plani për vendosjen e sistemit për video mbikëqyrje

1. Video mbikëqyrja realizohet nëpërmjet kamerave të vendosura në hapësirat kritike në UEJL. Kamerat janë të drejtuara vetëm për kontroll të hapësirave kritike në UEJL.
2. Paraqitja grafike e vendosjes së kamerave për realizimin e video mbikëqyrjes:

